

Sibel Gutiq

From: Flurim Arifi
Sent: Wednesday, March 18, 2026 3:18 PM
To: Sibel Gutiq
Cc: Mimoza Karameta
Subject: FW: Kërkesë për anashkalim të afatit për konsultim publik – Plani i Veprimit 2026–2028 për PQH

Përshëndetje Sibel,

Duke u bazuar në emailin e mëposhtëm dhe në kërkesën tonë të aprovuar nga Sekretari, ju lutem që Plani i Veprimit 2026–2028 të publikohet për konsultim publik, duke aplikuar procedurën e përshpejtuar përmes anashkalimit të afateve standarde ligjore.

Ky veprim konsiderohet i arsyeshëm duke pasur parasysh procesin e gjerë paraprak të konsultimeve dhe nevojën për të vazhduar me hapat e mëtejme procedural për miratim.

Faleminderit për bashkëpunimin.



Me respekt,

Ph.D.c. Flurim Arifi

Drejtore i Departamentit për Digjitalizimin e Shërbimeve në Komuna
Divizioni për Partneritetin për Qeverisje të Hapur – PQH
Divizioni për E-KOMUNAT dhe Qytetet Inteligjente
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Qeveria e Republikës së Kosovës
📍 Adresa: Ish-Rilindja XI, Zyre Nr. 1119, 10000 Prishtinë, Kosovë
☎ Tel: +383 38 200 64 173
✉ Email: flurim.arifi@rks-gov.net
🌐 Web: www.mapl.rks-gov.net

From: Jeton Qela <jeton.qela@rks-gov.net>
Sent: Wednesday, March 18, 2026 3:13 PM
To: Flurim Arifi <Flurim.Arifi@rks-gov.net>
Cc: Edita A. Azemi <edita.a.azemi@rks-gov.net>; Erlinda Smirqaku <erlinda.smirqaku@rks-gov.net>
Subject: Re: Kërkesë për anashkalim të afatit për konsultim publik – Plani i Veprimit 2026–2028 për PQH

I nderuar,

Pas shqyrtimit të kërkesës suaj lidhur me anashkalimin e afatit të rregullt për konsultim publik dhe përshpejtimin e procesit për hartimin e Planit të Veprimit 2026–2028 për Partneritetin për Qeverisje të Hapur, ju njoftoj se e njëjta miratohet.

Duke marrë parasysh procesin gjithëpërfshirës të zhvilluar deri më tani, përfshirë konsultimet me palët relevante dhe dokumentimin përkatës, vlerësohet se janë përmbushur kushtet për shkurtimin e afatit të konsultimit publik.

Ju lutem të vazhdoni me hapat e mëtejme për finalizimin dhe procedimin e Planit për miratim në Qeveri.

Me respekt,

On 18 Mar 2026, at 14:45, Flurim Arifi <Flurim.Arifi@rks-gov.net> wrote:

I nderuar z. Sekretar,

Në kuadër të procesit të hartimit të Planit të Veprimit 2026–2028 për Partneritetin për Qeverisje të Hapur (PQH), ju drejtohem me kërkesë për anashkalim të afatit të rregullt për konsultim publik dhe për përshpejtimin e këtij procesi.

Arsyetimi për këtë kërkesë është objektiv dhe i bazuar në vetë procesin gjithëpërfshirës të ndjekur gjatë hartimit të Planit. Gjatë kësaj periudhe, janë zhvilluar një sërë konsultimesh dhe diskutimesh substanciale me palë të ndryshme të interesit, përfshirë:

1. organizimin e takimeve të shumta me përfaqësues të shoqërisë civile;
2. konsultime me institucionet relevante në nivel qendror dhe lokal;
3. përfshirjen e organizatave dhe grupeve që përfaqësojnë komunitetet joshumicë;
4. realizimin e anketave me akterë institucionalë dhe të shoqërisë civile.

Këto aktivitete kanë siguruar një proces të gjerë dhe gjithëpërfshirës konsultimi, duke reflektuar kontributin e drejtpërdrejtë të palëve të interesit në përmbajtjen e Planit të Veprimit.

Për më tepër, i gjithë procesi i konsultimeve dhe diskutimeve disa mujore është dokumentuar dhe është i verifikueshëm përmes platformës përkatëse (Google Site: <https://sites.google.com/view/kosovoopengovernmentactionplan/home?authuser=0>), e krijuar posaçërisht për këtë qëllim.

Duke marrë parasysh sa më sipër, vlerësojmë se ekzistojnë kushte të arsyeshme për shmangie nga afati standard i konsultimit publik dhe për përshpejtimin e procedurave, me qëllim të vazhdimin me hapat e mëtejme për miratimin e Planit në Qeveri.

Në këtë drejtim, propozojmë që periudha e konsultimit publik të zhvillohet nga data 18 mars 2026 deri më 31 mars 2026.

Ju lutem për shqyrtimin e kësaj kërkesë dhe miratimin tuaj.

Faleminderit për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin.



Republika e
Kosovës

Me respekt,

Ph.D.c. Flurim Arifi

Drejtor i Departamentit për Digjitalizimin e Shërbimeve në Komuna

Divizioni për Partneritetin për Qeverisje të Hapur - PQH

Divizioni për E-KOMUNAT dhe Qytetet Inteligjente

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Qeveria e Republikës së Kosovës

📍 Adresa: Ish-Rilindja XI, Zyre Nr. 1119, 10000 Prishtinë, Kosovë

☎ Tel: +383 38 200 64 173

✉ Email: flurim.arifi@rks-gov.net

🌐 Web: www.mapl.rks-gov.net